

Thirrja është e hapur nga data 15.07.2024 deri me 22.07.2024

## TERMAT E REFERENCES

**KONSULENT/E PËR OFRIMIN E PUNËTORISË PËR SISTEMAZIMIN E ROLEVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË ANTARËVE TË KUVENDIT DHE TË BORDIT TË ORGANIZATËS, PËRGADITJA E PAKETËS SË RE ORIENTUESE TË STAFIT TË ORGANIZATËS DHE HARTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË VLERËSIMIT PËR STAFIN.**

<b>Organizata</b>	<b>OJQ "NEVO KONCEPT"</b>
<b>Objektiva</b>	<b>Zhvillimi i punëtorisë 2 ditore dhe Mbështetja e Organizatës Nevo Koncepti për Sistematizimin e roleve dhe përgjegjësi të Anëtarëve të Kuvendit dhe të Bordit të Organizatës, Përgatitja e paketës së re orientuese të stafit të Organizatës dhe Hartimin e planit individual të vlerësimit për stafin.</b>

### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin "Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

### 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

"Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

*Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.*

### 3. OBJEKTIVA

Objektiva e pare e angazhimit perfshin mbeshtetjen e organizates Nevo Koncepti ne zhvillimin e nje dokumenti per sistematizimin e roleve dhe pergjegjesive te anetareve te kuvendit dhe bordit te organizates. Sistematizimi i roleve dhe pergjegjesive te anetarëve të kuvendit dhe të bordit të organizatës është thelbësore për funksionimin e sukseshëm dhe efektiv të organizates. Përcaktimi i qartë i detyrave dhe pergjegjesive për secilin anëtar të bordit dhe kuvendit do te ndihmoje ne shmangjen e konfuzitetit dhe mbivendosjes se detyrave, përmirësimin e eficiencës në marrjen e vendimeve dhe zbatimin e tyre duke ndarë detyrat sipas kompetencave dhe aftësive të secilit anëtarë. Ky dokument do te siguroj; që të gjitha veprimet dhe vendimet e marra të jenë transparente dhe anëtarët të jenë llogaridhënës për veprimet e tyre. Gjithashtu qellimi perfshine edhe lehtësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis anëtarëve të bordit dhe kuvendit për të arritur qëllimet e përbashkëta të organizatës.

Objektiva e dyte e angazhimit perfshin zhvillimin e nje pakete orientuese per stafin e rri te organizates dhe hartimin e nje planit individual zhvillimor per stafin e Nevo Koncepti. Përgaditja e një pakete orientuese për stafin e organizatës është një proces i rëndësishëm që ndihmonë në integrimin e punonjësve të rinj dhe i pajis ata me informacionin e nevojshëm për të qenë efektivë në rolet e tyre. Gjithashtu hartimi i planit individual të vlerësimit për stafin është proces që ndihmon në vlerësimin dhe zhvillimin e punonjësve brenda organizatës, duke përcaktuar qëllimet dhe objektivat për secilin punonjës. Proces i cili ndihmonë në sigurimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të stafit dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të organizatës.

Nevo Koncepti po kërkon një individë (konsulentë/e) për të zhvilluar punëtorinë 2 ditore dhe të mbështetur organizatën Nevo Koncepti në Sistematizimin e roleve dhe pergjegjesive të Anëtarëve të Kuvendit dhe të Bordit të Organizatës, përgaditja e paketës së re orientuese të stafit të organizatës dhe hartimin e planit individual të vlerësimit për stafin.

### 4. PËRVOJAT SHKATHETISITE E NEVOJSHME DHE KUALIFIKIMI

Konsulenti/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë universitare (preferohet niveli Master) në shkenca sociale, ekonomi, ose ndonjë fushë te ngjashme.
- 5-7 vjet përvojë pune si konsulent/e, në fushën e qeverisjes se brendshme te OJQ-ve, perfshire menaxhimin e burimeve njerezore, angazhimin e komunitetit dhe vullnetarizmin, menaxhim projektesh, hartiminte strategjive organizative zhvillimore, planeve të veprimit në nivelin qendror apo lokal, përvojë të punës në fushën e mbrojtjes sociale, punës ose dialogut social në fushën e avokimit dhe në zbatimin e strategjive të ngjashme - duke përfshirë hartimin e moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve;

- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve;
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me të rinj;
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore;
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.

## 5. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me datën 23 Korrik deri me 30 Gusht 2024. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgaditja e modulit të trajnimit.	Zhvillimi / adaptimi i programit të punëtorisë, përfshirë materialet.	1	Korrik 2024
2	Dita e parë: Ofrimi i punëtorisë "Sistematizimin e roleve dhe përgjegjësi të Anëtarëve të Kuvendit dhe të Bordit të Organizatës	Ofrimi i punëtorisë 3-ditore për një grup të pjesëmarrësve	1	Korrik 2024
	Dita e dytë: Ofrimi i punëtorisë: Përgaditja e paketës së re orientuese të stafit të Organizatës		1	Korrik 2024
	Dita e tretë: Ofrimi i punëtorisë: Hartimin e planit individual të vlerësimit për stafin		1	Korrik 2024
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin në punëtorinë Sistematizimin e roleve dhe përgjegjësi të	4	Korrik 2024

		Anëtarëve të Kuvendit dhe të Bordit të Organizatës, Përgatitja e paketës së re orientuese të stafit të Organizatës dhe Hartimin e planit individual të vlerësimit për stafin.		
	<b>Gjithsej:</b>		<b>8</b>	

## 6. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i modulit të trajnimit dhe planit të punëtorisë;
- Sistematizimin e roleve dhe përgjegjësi të Anëtarëve të Kuvendit dhe të Bordit të Organizatës;
- Përgatitja e paketës së re orientuese të stafit të Organizatës
- Hartimin e planit individual të vlerësimit për stafin

## 7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV;
- b) Oferta teknike: metodologjia e propozuar për zhvillimin e modulit të punëtorisë dhe hartimin e dokumentit përkatës;
- c) Letër Motivuese;
- d) Dy (2) referenca;
- e) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime;
- f) Oferta Financiare.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 22.07.2024** në [e.qylangji@nevokoncepti.org](mailto:e.qylangji@nevokoncepti.org) duke e kopjuar (cc) në email [o.osmani@nevokoncepti.org](mailto:o.osmani@nevokoncepti.org).